



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0603**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "UNIVERS-M" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me valva te avullit me kontra flanaxha për fryrësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5" me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., më 13/11/2023, mori këtë:

## Vendim

**1. Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e "UNIVERS-M" SH.P.K. me nr. 2023/0603, e datës 22/08/2023, anulohet vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me valva te avullit me kontra flanaxha për fryrësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5", me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a., ndërsaaktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 07.03.2023, Korporata Energjetike e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryrësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5” me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1. Ndërsa me datën 04.08.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 103,200.00 €.

Me datën 09.08.2023, OE " UNIVERS-M " SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 14.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " UNIVERS-M " SH.P.K., me nr. 603/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me valva te avullit me kontra fllanxha për fryrësat e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5” me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën-paragrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues" UNIVERS-M " SH.P.K, janë parashtruar si në vijim:

*Ankuesi pretendon se “Kompania Univers - M shpk, ne Kërkesën për Ri-shqyrtim, do te prezantoje faktet përmbajtjesorë për te argumentuar shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues, me datën 04.08.2023, dërgon Njoftimin për Vendim te Autoritetit Kontraktues ne Portalin e E-prokurimit. Kërkesa për rishqyrtim për te dytën here është dërguar ne AK me datën 09.08.2023 ndërsa vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK është nxjerrë me datën 14.08.2023. Nëpërmjet këtij publikimi, Autoriteti Kontraktues, i ka prezantuar arsyet e dhënies se tenderit me te cilat nuk pajtohet operatori ekonomik Univers - M shpk. Operatori ekonomik Univers - M shpk ofron këto dëshmitë ne lidhje me dhënien tenderit: Operatori Ekonomik UNIVERS - M SH.P.K. pas marrjes se vendimit për dhenie te kontratës me dt.05.08.2023 i jemi drejtuar Autoritetit Kontraktues me një Kërkesë për qasje ne dokumentacion e dorëzuar nga Operatoret tjerë Ekonomik dhe AK me dt. 07.08.2023 na është përgjigjur duke na*

vene ne dispozicion dokumentacionin me qasje te kufizuar te OE tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit: për kompaninë: Novamat shpk , RH shpk dhe ND shpk. Për Novamat dhe RH shpk më është ofruar qasje ne dokumentacioni tenderues. Kurse për firmën N D shpk te shpallur fitues kame pasur qasje te kufizuar ne dokumentacion nga zyrtari i prokurimit ne shkelje te nenit 10(5) te Lpp-se te cilin konsiderojmë se e kane bere për te arsyetuar për zgjedhjen e gabuar qe është bere me ofertuesin e papërgjegjshëm, ku nuk më është ofruar qasje për dokumentacionin sipas nenit 9.1 dhe 9.2 te dosjes se tenderit (bashkangjitur keni Procesverbali për Qasje publike ne dokumentacion nga takimi i mbajtur ne ZEP - KEK-sha d1.07.08.2023) Ne Seksionin I FLETA E TE DHENAVE TE TENDERTT (FTD) neni 9.1 & 9.2 Dëshmitë e kërkuara dokumentare janë: 1. Qertifikata (Qertifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001:2015) me te cilën dëshmohet se prodhuesi prodhon enët nen presion. 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike te vulosura nga prodhuesi i valvave dhe te gjitha pjesëve të valvave, me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Dokumentacioni i larte shënuara nga zyrtari i prokurimit nuk me është ofruar me arsyetimin se janë sekret afarist , pasi qe Operatori Ekonomik ND shpk. ka plotësuar Aneksi 3 Kërkesë për sekret afarist, ku e ka futur nen sekret afarist i terë dokumentacioni i prodhuesit (bashkangjitur Aneksi 3 i OE ND shpk) Kjo është ne kundërshtim me nenin 10.5 te LPP-se, Ligjit për qasje ne dokumentet publike, për arsye se certifikata ISO 9001 :2015 është dokument publik dhe nuk ka asnjë element qe mund te konsiderohet si sekret te cilin vlerësim duhet te beje Autoriteti Kontraktues. Certifikata ISO 9001 :2015 lëshohet nga organet kompetente te specializuara te pavarura dhe mbajta si sekret e këtij dokumenti është ne shkelje te LPP-se dhe Ligjit për qasje ne dokumentet publik, Katalogu i prodhuesit nuk është dokument sekret pasi qe katalogu është dokument publik, e pasi qe këtu kemi te bëjmë me shpenzim te parasë publike te cilat para i përkasin Qytetareve dhe kane te drejte te din ku behet shpenzimi i parasë publike, për me tepër për një OE qe është i papërgjegjshëm i cili ka pranuar me pohimin ne heshtje pa asnjë ankese, kundërshtim kur është eliminuar i papërgjegjshëm nga AK. Duhet potencuar se ne raportin e vlerësimit dt.03.04.2023 (bashkangjitur keni raportin e vlerësimit) dhe Njoftimin mbi vendimin e AK përmes platformës elektronike te d1.13.04.2023 ku AK - KEK sha e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit janë te pa përgjegjshëm, vetëm OE UNIVERS - M SHPK. i pa kënaqur me vendimin e AK ka parashtruar Ankese ne OSHP dhe është nxjerrë vendimi 202310251 dt.23.06.2023 ne këtë vendim ankesa e jone Aprovohet si e bazuar. Dhe me Njoftimin mbi vendimin e AK te dt.04.08.2023 dhe sipas raportit te Rivlerësimit te dt.14.07.2023 (bashkangjitur keni raportin e rivlerësimit) kompania UNIVERS - M SHPK është oferte e përgjegjshme dhe i ka plotësuar te gjitha kërkesat ne dosjen e tenderit por nuk është oferte me çmimin me te ulët. Gjate kontrollimit te dokumentacionit te marrur ne ZEP d1.07.08.2023 për qasje ne dokumentacion ne raportin e vlerësimit te dt.03.04.2023 kemi konstatuar këtë shkelje ligjore: Ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për operatorin ekonomik ND shpk dhe RH shpk le d1.12.04.2023 dhe ne raportin e komisionit vlerësues te dt.03.04.2023 Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale ka mospërputhje ne përshkrimin e anulimit - nuk është përshkrimi i njëjtë për arsyet e anulimit : Nga raporti i vlerësimit - komisioni vlerësues i d1.03.04.2023 perpos mangesive tjera te anulimit ne raport e ka cekur se OE ND shpk dhe RH

shpk ne Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme nuk është plotësuar rubrika: Pjesët e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi, pra nuk është plotësuar aneksi 1 i specifikimeve teknike te detyrueshme siç është kërkuar nga AK ne dosjen e tenderit. Kurse ne publikimin nga zyrtari përgjegjes i prokurimit (ZPP) ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar te dt.12.04.2023 për operatorin ekonomik ND shpk dhe RH shpk (bashkangjitur Letrat standarde) ne anulim nuk është cekur hiq ne Aneksin 1 Specifikimet teknike te detyrueshme nuk është plotësuar rubrika: Pjesët e ofruara nga OE, Produkti i ofertuar dhe prodhuesi, edhe pse i njëjti ka nënshkruar dhe aprovuar raportin e vlerësimit te datës 03.04.2023. Nëse nga Operatoret Ekonomik ofertues ne këtë aktivitet te prokurimit nuk plotësohet: Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme ne rubrikat ku është kërkuar te plotësohen rubrikat: Pjesët e ofruara nga OE , Produkti i Ofertuar dhe Prodhuesi ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion te mëtejshëm, (bashkangjitur gjeni udhëzuesin Nr.001/2023 për prokurimin publik - KRPP), nga kjo vërtetohet se OE ND shpk edhe herën e pare ka qene ofertues i papërgjegjshëm dhe nuk ka bere asnjë ankese ne lidhje me eliminim si ofertues i pa përgjegjshëm dhe për habi pasi qe lënda kthehet ne rivlerësim komisioni rivlerësues idt.14.07.2023 nuk i merr parasysh këto mangësi dhe ne vërejtjet përmbyllëse ne lidhje me vlerësimin e tenderëve te përgjegjshëm konstaton se vetëm dy oferta i plotësojnë te gjitha kërkesat ne dosjen e tenderit dhe komisioni i vlerësimit propozon qe oferta e operatorit ekonomik ND shpk si oferte me e lire dhe e përgjegjshme te shpërblehet me kontrate. Kur kësaj i shtohet fakti se gjate verifikimit te dokumenteve për qasje publike te marrura ne ZEP, OE ND shpk dhe RH shpk. kane ofertuar me te njëjtin prodhues Modus Micevskidooel Shkup -Maqedoni dhe ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar te dt.04.08.2023 për firmën RH shpk ne anulim është e cekur se: Ka vetëm vizatimin dhe përshkrimin nga AK - KEK-u te vërtetuar, por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me prerje tërthore nga prodhuesi siç është kërkuar ne nenin 9.1dhe 9.2 ne FDT te DT dhe për këto arsye kemi dyshime te bazuara për OE ND shpk. te shpallur fitues, AK i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, siç është kërkuar ne nenin 9.1dhe 9.2 ne FDT te DT pasi qe dokumentet e prodhuesit për firmën ND shpk nuk mu kane ofruar nga zyrtari i prokurimit, dhe është nga i njëjti prodhues qe dorëzohen dy oferta nga dy OE, ku ne njërën oferte te OE RH shpk eshte konstatuar i papërgjegjshëm sepse i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, dhe logjikisht i mungojnë edhe te OE ND shpk, sepse si ka mundësi nga i njëjti prodhues ne njërën oferte mos te plotësoj kërkesat e dosjes se tenderit ndërsa ne tjetrën oferte te OE ND shpk shpallet fitues dhe neve na pamundësohet qasja ne dokumente sipas nenin 9.1dhe 9.2 te dosjes se tenderit: Dëshmia e kërkuar dokumentare për piken 1 dhe piken 2 . Dyshimet tona ne lidhje me dokumentacionin e prodhuesit për firmën ND shpk do te kërkojmë qe te verifikohen gjate fazave te ankesave sepse dyshojmë qe nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit , ku shihet nga kronologjia dhe lindshmëria e fakteve, provave një nga një nga vlerësimi i pare deri te vlerësimi i dyte, pranimi i pohimit ne heshtje, se ka dorëzuar ofertën e papërgjegjshme OE ND shpk pa asnjë ankese, kundërshtim kur është eliminuar nga AK. Për me tepër deklarata nen betim dhe dokumentet tjera te nënshkruar nga OE ND shpk nuk janë nënshkruar nga pronari ose përfaqësuesi i autorizuar ne formularin e regjistrimit me numër unik identifikues ne Agjencinë regjistrimeve te bizneseve, dhe edhe për këtë fakt është i

*papërgjegjshëm, sepse nuk mund të nënshkruaj dokumenti personi i paautorizuar në emër të kompanisë, i cili për më tepër ka të paraqitur numrin e punëtoreve 1 (një) në Arbk, dhe nuk mund të bartet përgjegjësia ligjore nga pronari i kompanisë të një personi i cili sipas regjistrit në Arbk nuk është as punëtor i kompanisë. Përgjigjet e OE Univers - M shpk në përgjigjet e AK sipas pikave të renditura: 1.OE Ankues është thirrur në komisionin paraprak dhe në vendimin e OSHP-se nr.202310251 d1.23.06.2023 sepse behet fjalë për të njëjtin projekt, kjo behet me qellim që të mos respektohet vendimi i OSHP-se, dhe veprimet e parregullta për të mbuluar nga Autoriteti Kontraktues, madje një zyrtar është caktuar dy here në komisionet e vlerësimit, edhe në komisionin e parë të vlerësimit, edhe në komisionin e dytë të rivlerësimit që konsiderojmë se është veprim i parregullt nga AK. 2.OE Ankues ka pasur qasje të kufizuara për pikat e cekura në Procesverbal të dt.07.08.2023(bashkangjitur Procesverbali për Qasje publike në dokumentacion nga takimi i mbajtur në ZEP -KEK-sha d1.07.08.2023). Kjo ka të bëjë sepse nuk është dhënë qasje në Katalogun e prodhuesit dhe Certifikatën ISO 9001:2015 të prodhuesit që nuk janë dokument sekret pasi që ISO 9001:2015 dhe Katalogu është dokument publik. 3. OE Ankues në Kërkesën për Rishqyrtim të dt.09.08.2023 ka cekur: Kur kësaj i shtohet fakti se gjatë verifikimit të dokumenteve për qasje publike të marruara në ZEP, OE ND shpk dhe RH shpk. kanë ofertuar me të njëjtin prodhues Modus Micevski dool Shkup - Maqedoni dhe në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të dt.04.08.2023 për firmën RH shpk në anulim është e cekur se: Ka vetëm vizatimin dhe përshkrimin nga AK - KEK-u të vërtetuar, por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me prerje tërthore nga prodhuesi siç është kërkuar në nenin 9.1 dhe 9.2 në FDT të DT dhe për këto arsye kemi dyshime të bazuara OE ND shpk. të shpallur fitues nga AK i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, siç është kërkuar në nenin 9.1 dhe 02 në FDT të DT pasi që dokumentet e prodhuesit për firmën ND shpk nuk mu kanë ofruar nga zyrtari i prokurimit, dhe është nga i njëjti prodhues që dorëzohen dy oferta nga dy OE, ku në njërin oferta të OE RH shpk është konstatuar i papërgjegjshëm sepse i mungon katalogu i prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit, dhe logjikisht i mungojnë edhe të OE ND shpk, sepse si ka mundësi nga injeji prodhues në njërin oferta mos të plotësojë kërkesat e DT ndërsa në tjetrën oferta të OE ND shpk shpallet fitues dhe neve na pamundësohet qasja në këto dokumente. Kërkojmë nga OSHP-ja të verifikohen dokumentet e poshtë shënuara pasi që këto dokumente nuk më janë dorëzuar nga zyrtari i prokurimit në Kërkesën tonë për qasje në dokumente: Në Seksionin II FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FTD) nën 9.1 & 9.2 Dëshmitë e kërkuara dokumentare janë: "1. Qertifikata (Qertifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 :2015) me të cilën deshmohet se prodhuesi prodhon enët nën presion. 2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si kataloge pjesë të katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike të vulosura nga prodhuesi i valvave dhe të gjitha pjesëve të valvave, me përshkrim teknikë detale për artikujt që ofertonin Pasi që OE ND shpk i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me prodhues nga Maqedonia kërkojmë të verifikohet edhe gjuha e dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, pasi që gjuha zyrtare në dokumentacion tenderues duhet të jetë në gjuhën shqipe, angleze dhe gjuhën serbe. 4. OE Ankues Univers - M shpk nuk është thirrur që OE i rekomanduar për kontratë ka vetëm vizatimet e AK - KEK sha dhe nuk ka të dorëzuar katalog të prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit pasi që këto dokumente sipas nenit 9.1 dhe 9.2 nuk na janë ofruar nga zyrtari i prokurimit OE ankues i ka dyshimet pasi që dy ofertues ND shpk dhe RH*

shpk kane ofertuar me te njëjtin prodhues: Modus Micevski dooel Shkup - Maqedoni dhe komisioni i Rivlerësimit me dt.14.07.2023 ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar te d1.04.08.2023 për firmën RH shpk ne anulim është e cekur se: Ka vetëm vizatimin dhe përshkrimin nga AK - KEK-u te vërtetuar, por nuk ka as katalog dhe as vizatimin me dimensione dhe prerje tërthore nga prodhuesi siç është kërkuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 ne FDT te DT(bashkangjitur letrën standarde për tenderuesin e eliminuar RH shpk.) 5. OE ankues është thirrur qe nuk është plotësuar Aneksi I Specifikimet teknike te detyrueshme rubrika: Pjesët e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi, pra nuk është plotësuar aneksi I i specifikimeve teknike te detyrueshme siç është kërkuar nga AK ne dosjen e tenderit.( bashkangjitur Aneksi I Specifikimet teknike te detyrueshme i pa plotësuar ne rubrikat e kërkuara ne DT nga firma ND shpk.) AK është thirrur se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara te cilat përputhen me ato te ne Aneksin I Specifikimet teknike te detyrueshme te dosjes se tenderit - Neni 3.1 ku shihet qarte qe OE ND shpk i rekomanduar për kontrate nuk e ka te plotësuar Aneksin I Specifikimet teknike te detyrueshme ne rubrikat : Pjesët e ofruara nga OE , Produkti i ofertuar dhe prodhuesi Nëse OE nuk e ka të plotësuar specifikimin teknik për mallrat e ofruara ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion te metutjeshme ( bashkangjitur gjeni udhëzuesin Nr.001/2023 për prokurimin publik - KRPP faqe 41 dhe faqe 42) 6. AK thirret ne Deklaratën nen betime cila nuk është plotësuar nga pronari i kompanisë (kompania ne regjistrin e regjistruar ne Arbk ka një punëtor te cilin deklaratë duhet te nënshkruaj pronari i kompanisë për te marre obligime dhe përgjegjësi ligjore e jo personi qe sipas regjistrin ne Arbk nuk është as punëtor i kompanisë. Kërkesa për rishqyrtim trajtohet nga Zyrtari Përgjegjes i Prokurimit sipas nenit 63 të Rregullores nr. 01/2022 për prokurimin publik e jo nga komisioni vlerësues apo rivlerësues siç është shënuar ne vendimin e datës 14.08.2023 sepse për këtë: Komisioni vlerësues apo rivlerësues nuk ka as autorizim ligjor, as kompetence për te trajtuar kërkesën për rishqyrtim dhe rrjedhimisht vendimi i datës 14.08.2023 është pa efekt juridik, dhe trajtimi i bere është nga komisioni vlerësues - rivlerësuar, që nuk kanë as autorizim ligjor nga ligjvënësi as kompetencë për te trajtuar kërkesën për rishqyrtim. ”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE UNIVERS-M " SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 28, 56, 59, 60 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 25/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 603/23, ndërsa me datë 11/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0603 me rekomandimet si në vijim: “*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues dhe përmes sistemit e – prokurimi ka theksuar “Mbështetur në nenin 115.1 të Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (LPP), Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën E Përgjithshme Administrative, operatori ekonomik (OE) “UNIVERS-M” Sh. P. K ne afatin ligjor në cilësinë e palës së interesuar me interes materialo juridik i cili është në rrezik të dëmtimit nga shkeljet e pretenduara nga raporti i ekspertit shqyrtues nr.2023/0603 i datës 11.09.2023 që mund të sjellë vendimin që mund të merret nga Paneli Shqyrtues në OSHP. Fillimisht e njoftojmë Panelin Shqyrtues në OSHP se mbesim në tersi si në ankesën nr. 2023/0603 të datës 22.08.2023, pretendimeve ankimore të mbështetur në fakte, prova, LPP, rregulla të prokurimit publik, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë objektive, profesionale nga ekspertet në raportin nr.2023/0603 të datës 11.09.2023. Me ekspertizën nr.2023/0251 i datës 17.05.2023 të përgatitur nga dy ekspert, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik të autorizuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (Oshp) është aprovuar ankesa e OE ‘Univers - M’. Nga OSHP me pas është nxjerrur vendimi nr. 2023/0251 i datës 23.06.2023 me të cilin është aprovuar ankesa e OE ‘Univers - M’. Jemi në dilema dhe kemi mëdyshjet tona se në raportin e eksperteve nr.2023/0603 është ndërruar eksperti teknik shqyrtues i caktuar Arben Lajqi nga i cili kemi pretendimet tona të bazuara në fakte, prova dhe LPP se janë bërë shkeljet ligjore me të cilën tenton të dëmtojë OE ‘Univers - M’, dhe të sjellë përfitim OE “ND” SHPK i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk plotëson kriteret e përzgjedhjes, dhe Aneksin 1 specifikimet teknike të detyrueshme të kërkuara në dosjen e tenderit. Data e autorizimit të eksperteve nga OSHP është data 25.08.2023 (data e ankesës se bërë është 22.08.2023). Fakti është se prova e cekur nga ekspertja shqyrtuese në faqen nr.10 të raportit shënon se kjo procedure e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ku eksperti teknik i fushës ka nxjerrë raport të ekspertizës nr.251/23 të datës 17.05.2023, po ashtu edhe Paneli Shqyrtues i ka gjykuar me vendimin PSH. nr. 251/2023 të datës 23.06.2023 duke aprovuar ankesën si të bazuar të OE “UNIVERS-M” duke kthyer lenden në vlerësim. Fuqimisht kundërshtohet vlerësimi i ekspertit teknik Arben Lajqi i cili thekson se OE ND sh.p.k nuk ka pranuar në heshtje eliminimin pasi që ky aktivitet ka qenë në proces dhe nuk ka pasur ndërprerje të procedurës. Në pari kjo çështje nuk është në kompetencën profesionale të ekspertit teknik, pasi që është çështje që i takon ekspertit shqyrtues, dhe nuk është çështje teknike, ku me këtë shihet se eksperti teknik Arben Lajqi ka qenë jo objektiv dhe tendencioz. Është fakt notor se OE “ND” shpk ka pranuar në heshtje se është i papërgjegjshëm sepse nuk ka kundërshtuar me asnjë shkresë, fakt, eliminimin dhe vlerësimin si i papërgjegjshëm në raportin e vlerësimit të komisionit të autoritetit kontraktues (AK) të datës 03.04.2023, dhe letrën standarde të tenderuesit të eliminuar të datës 12.04.2023 për OE “ND” sh.p.k nga AK. Kjo për faktin se vetë OE ND shpk nuk ka kundërshtuar me asnjë shkresë papërgjeghmerinë e tenderit dhe është fakt i pranueshëm se heshtja, moskundërshtimi nga OE ND shpk është se nuk ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit. Për më tepër paraqet edhe diskriminim, trajtim jo të barabartë ndaj OE “UNIVERS-M” i cili ka fituar të drejtën me ankesë pas parashtrimit në OSHP ku ka dorëzuar faktet, arsyetimet ligjore, ndërsa OE ND sh.p.k nuk ka pasur asnjë



ankese... ” i njëjti ka dorëzuar edhe email me datën 14.09.2023 duke kundërshtuar e raportin e ekspertizës nr.2023/0603 te datës 11.09.2023. .

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " UNIVERS-M " SH.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0603 ka sqaruar si në vijim:

*“Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës furnizim. Vlera e parashikuar 103,200.00 (me TVSH) €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulët. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratë. Ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qene objekt i shqyrtimit në OSHP ku palët janë të njëjta, por tani pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratë për dallim nga here e parë që ka qene ankesa kundër anulimit të aktivitet te prokurimit. Eksperti teknik i fushës, ku nxjerr raport të ekspertizës me Nr.251/23 të datës 17.05.2023. Po ashtu edhe Paneli Shqyrtues i ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.251/2023 të datës 23.06.2023 duke e aprovuar ankesën si të bazuar dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.*

***Eksperti teknik/shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit ne sistem e-prokurimit, shqyrtimit të rrjedhjes se procedurës, pretendimeve të palës në ankesë ka nxjerrë këtë konkludim:***

*Autoriteti Kontraktues në kërkesat për vlerësim përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofroj:*

- 1. Certifikatat e produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet,*
- 2. Katalogë apo prezantime grafike (vizatimet ) dhe ose fotografi të produkteve për furnizim, b ashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt qe ofertoni, ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar*
  - 1. Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015 ) me të cilën dëshmohet se prodhuesi*

*prodhon enët nën presion,*
  - 2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut nga prodhuesi dhe ose vizatimet autentike të vulosura nga prodhuesi i valvave dhe të gjitha pjesëve të valvave, me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.*

*Pas ekzaminimit te materialeve te OE “UNIVERS-M” SH.P.K dhe ND SHPK dhe pretendimeve të tij kundër vendimit për shpërblim me kontratë të OE ND SH.P.K eksperti teknik sqaron si në vazhdim:*



*Për këtë lëndë ka patur edhe një vendim të OSHP-së 2023/0251 dt.04/05/2023 dhe sipas këtij vendimi lënda kthehet në rivlerësim dhe i aprovohet ankesa si e bazuar për OE "UNIVERS-M" SH.P.K. Bazuar në pretendimin ankimor të OE ankues në të cilin pretendohet që në vendimin e parë për eliminime të OE ND sh.p.k në heshtje ka pranuar eliminimin kjo nuk qëndron pasi që ky Aktivitet ka qenë në proces dhe nuk ka pasë ndonjë ndërprerje të procedurës.*

*Ne pretendimin ankimorë që nuk mund të nënshkruaj personi i paaautorizuar pas shqimit të dokumentacionit të prezentuar shihet që ekziston autorizimi në të cilin Besnike Maloku Morina autorizohet nga pronari Avni Musliu dhe konstatohet që ky pretendim është **i pabazuar**.*

*Ne pretendimin ankimorë që OE i propozuar për kontratë nuk ka plotësuar specifikimin teknik për mallrat e ofruara vlenë të theksohet se ajo rubrikë ka karakter informativ dhe të njëjtat të dhëna në vazhdim prezantohen në dokumentacionin teknik dhe ky pretendim konsiderohet **i pjesërisht i bazuar**.*

*OE "UNIVERS-M" SH.P.K. potencon se nuk ka pasë qasje në dokumentacion derisa i njëjti ka futë si sekret afarist katalogun e prodhuesit dhe në bazë të komunikimeve që ka pasë me AK ka pasë qasje të kufizuar dhe ky pretendim ankimorë konsiderohet **i pabazuar**.*

*Po ashtu edhe OE ND SH.P.K ka futë si sekret afarist komplet dokumentacionin e prezentuar dhe pas ekzaminimit të materialeve dhe katalogjeve është evidente që komisioni i vlerësimit të AK ka vlerësuar në mënyrë profesionale këtë OE dhe se produkti i ofruar i plotëson të gjitha kërkesat e specifikimeve teknike të detyrueshme të Aneksit 1. Duke u bazuar në kërkesat për sekrete afariste nuk po prezantojmë katalogjet dhe certifikatat në ekspertizë për OE të propozuar për kontratë, por jam i gatshëm që në momenti që kërkohet të prezantojmë anëtareve të panelit shqyrtues provat në rast nevojë.*

*Pretendimet ankimore të OE "UNIVERS-M" SH.P.K në të cilat bazohet në dokumentacionin e OE RH sh.p.k se kanë ofertuar me produkte të të njëjtit prodhues me OE të propozuar për kontratë dhe derisa nuk posedon ky OE supozon që edhe OE i shpallur fitues nuk ka katalogje dhe certifikata janë të pabazuara, pasi që pas ekzaminimit të katalogëve dhe certifikatave i njëjti ka prezentuara katalogje dhe certifikata dhe i plotëson të gjitha kriteret në përputhje me kërkesat e DT dhe specifikimeve teknike të detyrueshme të Aneksit 1.*

*Komisioni vlerësues i AK në raportin e tyre shpallë të përgjegjshëm dy OE ( në këtë rast OE ankues dhe të propozuar për kontratë ) dhe propozon për kontratë OE më të lirë ekonomikisht pasi që ka qenë kriteri i DT. ”*

*Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues dhe teknik i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "UNIVERS-M " SH.P.K., Argumentimi në raportin e eksperteve është i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli Shqyrtues sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e eksperteve në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues por është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "UNIVERS-M " SH.P.K janë të pa bazuara.*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me valva te avullit me kontra flanaxha për fryrësas e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5” me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperteve, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Vendimin e AK - B58 të datës 04.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me valva te avullit me kontra flanaxha për fryrësas e blozës ne kazanin e bl.A3,A4,A5” me numër të prokurimit KEK-23-1746-1-2-1, dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

PSH konstaton se çështja kryesore mbi të cilën vuri vëmendje kryesore sa i përket vendimarrjes duke i marrë në konsideratë faktet dhe sqarimet e lartcekura, gjithashtu bazuar edhe në Raportit e Vlerësimit dhe Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar, të dates 13.04.2023, AK kishte eliminuar OE ND Shpk dhe të gjithë OE pjesëmarrës. Dhe lidhur me këtë eliminimin vetëm njëri OE ka qenë ankues duke e mbrojtur eliminimin e tij dhe si pasoj ka rrjedh vendimi 251/23 i datës 23.06.2023.

Paneli konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, OE ND Shpk, nuk ka shfrytëzuar të drejten e ankesës ndaj atij vendimi të autoritetit kontraktues konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/A, nëse si palë e paknaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP, pastaj nëse është e nevojshme edhe në gjykata kompetente. Këtë nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për arsytet e lartëcekura për këtë aktivitet të prokurimit. Në momentin kur një OE pajtohet me eliminimin e tij duke mos e atakuar vendimin e AK konform këshillës juridike dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj, ky OE e fiton statusin e palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Për këto çështje OSHP qëndron konsistente në vendimet e saja sa i përket kësaj çështje dhe në vendimet e saja nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues që i kanë pasur ndaj OE të cilët kanë qenë të eliminuar dhe të cilët nuk e kanë mbrojtur veten me kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë duke i trajtuar si palë pa interes. Po ashtu edhe OE në ankesat e tyre, të rralla janë rastet kur atakojnë OE të cilët janë të eliminuar ngase i klasifikojnë si palë pa interes dhe pretendimet i kanë vetëm ndaj të rekomanduarit apo ndaj atyre të cilët janë të pasukseshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi.

Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lartë, PSH konstaton se, OE i rekomanduar për kontratë, “ND Shpk”, për këtë aktivitet të prokurimit është i papërgjegjshëm dhe përmes këtij vendimi eliminohet nga pjesëmarrja në të.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga

kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - " UNIVERS-M " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: